

## PLAN VEPRIMI

### Zbatimi i rekomandimeve të KLSH-së viti 2019, për auditimin tematik mbi “Investimin e kryer për ndërtimin e Muzeut Kombëtar të Artit Mesjetar” nga bashkia Korçë.

NR	REKOMANDIMET	Niveli i prioritetit	Ref. Parag. ne raport	Reagimi i menaxhimit (aktivitetet që do të kryhen)	Afati i përcaktuar	Personat përgjegjës për realizim e rekomandimeve
<b>A. MASA ORGANIZATIVE</b>						
1.1	Autoriteti Kontraktor, bashkia Korçë dhe Njësia e Prokurimit, të marrin masa për përcaktimin e kriterëve të veçanta për kualifikim në përputhje me kërkesat e cilësuar në specifikimet teknike, si dhe përcaktimin e dokumentacionit të duhur, që duhet të paraqitet nga operatorët ekonomikë, për përmbushjen e këtyre kriterëve.	I mesëm	Fq.10-28 Pika 2.2 Raporti përfundimtar i Auditimit	Bashkia Korçë, Njësia e Prokurimit do të vijojë të përcaktojë kriteret për kualifikim në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimet.	Menjëherë dhe në vijimësi	Matilda Stena  Njësia e prokurimit
2.1	Titullari i Autoritetit Kontraktor, Bashkia Korçë, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa për eliminimin e rasteve të tilla, ku mungojnë analizat, argumentimi si dhe referencat për cmimet e preventivuara, me pasojë rritjen e riskut për shkaktimin e efekteve financiare negative, në përlogarritjen e vlerës limit të kontratës.	I lartë	Fq.10-28 Pika 2.3 Raporti përfundimtar i Auditimit	Nga bashkia Korçë, për minimizimin e risqeve dhe efekteve financiare negative në përlogarritjen e vlerës limit të kontratës, do të merren masa të menjëhershme dhe në vijimësi për eliminimin e rasteve kur mungojnë analizat e çmimeve, argumentimi i tyre si dhe referencat në cmimet e preventivuara.	Menjëherë dhe në vijimësi	Matilda Stena  Njësia e prokurimit
3.1	Nga AK, bashkia Korçë të merren masa që objektet që prokurohen, të jenë të pajisur me projektin e plotë të zbatimit, për të shmangur problemet teknike gjatë zbatimit të punimeve dhe ndryshimet e panevojshme	I ulët	Fq. 32-37 Pika 5.1 Raporti Përfundimtar i Auditimit	Të gjitha objektet që prokurohen do të pajisen me projektin e plotë të zbatimit, të miratuar nga bashkia Korçë.	Menjëherë dhe në vijimësi	Zhaneta Lubonja
4.1	Nga AK, bashkia Korçë të merren masa për menaxhimin e kontratave të punimeve të ndërtimit, në mënyrë që të bëhet zbatimi korrekt i	I ulët	Fq. 32-37 Pika 5.1 dhe	Do të merren masa për menaxhimin e kontratave të punimeve të ndërtimit	Menjëherë dhe në	

	projektpreventivit të objektit dhe nga mbikqyrësi e kolaudatori i punimeve, të verifikohet me përgjegjësi përmbajtja e dosjes teknike, me të gjithë elementët e saj, me qëllim situacionimin e volumeve të punës në mënyrë të argumentuar teknikisht.		5.2 Raporti Përfundimtar i Auditimit	nëpërmjet verifikimit me përgjegjësi të dosjeve teknike, në të gjithë elementët e saj, të mbikqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve, me qëllim zbatimin korrekt të preventivit dhe situacionimin e volumeve të argumentuara teknikisht.	vijimësi	Leonard Gjançi
5.1	Nga AK, bashkia Korçë të merren masa për ngritjen e një grupi pune, i cili të kryejë verifikimin e të gjitha pajisjeve, ku të kontrollojë nëse janë vendosur sipas specifikimeve teknike dhe nëse janë funksionale	I lartë	Fq. 32-37 Pika 5.2 Raporti Përfundimtar i Auditimit	1.Të hartohet dhe të nënshruhet urdhëri i kryetarit të Bashkisë për ngritjen e grupit të punës , i cili do të kryejë verifikimin e të gjitha pajisjeve dhe do të kontrollojë nëse janë vendosur sipas specifikimeve teknike dhe nëse janë funksionale. 2.Grupi i punës të mbajë procesverbal në lidhje me sa më sipër.	Menjëherë	Leonard Gjançi
<b>B.1 MASA SHPERBLIM DEMI</b>						
1.1	Nga AK, bashkia Korçë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej <b>366.667 lek pa TVSh</b> nga BOE “Konstruksion 93” SHPK & “Xhengo” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit, sipas kontratës pa numur protokolli, datë 08.10.2015 me objekt “Infrastruktura e brendshme e Qendrës për Mbrojtjen dhe Promovimin e Kulturës/ Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar”, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt, jo në përputhje me specifikimet teknike të miratuara nga AK.	I mesëm	Fq. 32-37 Pika 5.2 Raporti Përfundimtar i Auditimit	1. Të kontabilizohet në buxhet si detyrim shuma prej <b>366 667 lekë</b> 2. Të njoftohen shoqëritë <b>”Konstruksion 93” shpk &amp; ”Xhengo”shpk</b> , për shpërblimin e dëmit prej <b>366 667 lekë</b> në mënyrë vullnetare. 3. Në rast të mos shpërblimit të dëmit në mënyrë vullnetare, përmbushja e tij do të kërkohet në rrugë gjyqësore. (hartimi i kërkesë padisë dhe ndjekja e procesit në të treja shkallët e gjykimit)	Menjëherë	Leonard Gjançi & Anxhela Dishnica & Valbona Ziko

2.1	Nga AK, bashkia Korçë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej <b>1.462.000 lek pa TVSH</b> nga BOE “Konstruksion 93” SHPK & “Xhengo” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit, sipas kontratës pa numur protokolli, datë 08.10.2015 me objekt “Infrastruktura e brendshme e Qendrës për Mbrojtjen dhe Promovimin e Kulturës/ Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar”, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e likuidimit të pajisjeve të pavendosura në objekt sipas preventivit të miratuar nga AK.	I lartë	Fq. 32-37 Pika 5.2 Raporti Përfundimtar i Auditimit	1. Të kontabilizohet në buxhet si detyrim shuma prej <b>1 462 000 lekë</b> 2. Të njoftohen shoqëritë <b>”Konstruksion 93” shpk &amp; ”Xhengo”shpk</b> , për shpërblimin e dëmit prej <b>1 462 000 lekë</b> në mënyrë vullnetare. 3. Në rast të mos shpërblimit të dëmit në mënyrë vullnetare, përmbushja e tij do të kërkohet në rrugë gjyqësore. (hartimi i kërkesë padisë dhe ndjekja e procesit në të treja shkallët e gjykimit)	Menjëherë	Leonard Gjançi & Anxhela Dishnica & Valbona Ziko
<b>B.2. SHPENZIME TE REALIZUARA NE KUNDERSHTIM ME KERKESAT LIGJORE TE PROKURIMIT DHE EFEKTE NEGATIVE NE MENAXHIMIN E FONDEVE ME EFEKTIVITET, EFIÇENCE DHE EKONOMICITET (3E)</b>						
1.1	Titullari i AK, të analizojë dhe të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësive dhe eliminimin e shkeljeve të cilësuara më lart me pasojë efekte financiare negative, në buxhetin e bashkisë Korçë, i cili në rastin konkret rezulton në vlerën <b>3.499.806 lekë pa TVSH</b> .	I lartë	Fq. 10-28 Pika 2.3 Raporti Përfundimtar i Auditimit	Titullari i AK, nëpërmjet grupit të punës të ngritur për rastin konkret, do të analizojë situatën dhe do të marrë masa për vijimësinë e procesit dhe eliminimin e shkeljeve me efekte financiare negative për buxhetin e bashkisë.	Menjëherë dhe në vijimësi	Anxhela Dishnica
2.1	Autoriteti Kontraktor, bashkia Korçë të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomik, të cilët edhe pse nuk kanë plotësuar kriteret e DT janë kualifikuar dhe shpallur fitues, në mënyrë që në të ardhmen të mos përsëriten veprime të tilla, të cilat çenojnë realizimin me cilësi të kontratave	I mesëm	Fq. 10-28 Pika 2.3 Raporti Përfundimtar i Auditimit	Bashkia Korce do të vijojë të kualifikojë dhe shpallë fitues operatorët ekonomikë vetëm në kushtet e plotësimit të kriterëve të miratuara në DST dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Menjëherë dhe në vijimësi	Matilda Stena & KVO
<b>C MASA ADMINISTRATIVE</b>						
1.1	Kryeinspektori i Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe të vendosë masë administrative me gjobë për mbikqyrësin e punimeve si më poshtë : BOE “Dea-Studio” & “Infrakonsult” SHPK,		Fq. 32-37	Kryeinspektori i IMT-së të bashkisë Korçë të fillojë menjëherë procedurat për vendosjen e gjobës, bashkimit të operatorëve “Dea-Studio” &		

	<p>përfaqësuar nga z. Ervin Taçi, gjobë në masën 50.000 lekë për shkeljet e konstatuara në cilësinë e mbikqyrësit të punimeve, në zbatimin e kontratës me objekt “Infrastruktura e brendshme e Qendrës për ruajtjen dhe promovimin e kulturës/Muzeu i Artit Mesjetar” me sipërmarrës punimesh BOE “Konstruksion 93” SHPK &amp; “Xhengo” SHPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën <b>366.667 lekë pa TVSh</b> si rrjedhojë e diferencave në punime të likuiduara por të pakryera në fakt dhe vendosjes së pajisjeve jo sipas specifikimeve teknike dhe jo funksionale në objekt në vlerën <b>1.462.000 lekë pa TVSh</b>.</p>	I mesëm	Pika 5.2 Raporti Përfundimtar i Auditimit	“Infrakonsult” SHPK, përfaqësuar nga z. Ervin Taçi, në masën 50.000 lekë, për shkeljet e konstatuara nga KLSH.	Menjëherë	Idlir Limllari
	<b>MASA DISIPLINORE</b>					
1.	<p>Në zbatim të nenit 58 “Llojet e masave disiplinore” të ligjit nr. 152/2013, dt. 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me ligjin nr.178/2014, dt.18.12.2014, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe nenin 64, shkronjën g të ligjit nr.139/2015, dt.17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, kryetari i bashkisë të vlerësojë shkeljet dhe masën disiplinore për: <b>Z. Bujar Meta</b>, inxhinier me detyrë specialist në Njësinë e prokurimit. Në cilësinë e personit përgjegjës për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, për shkeljet e mëposhtme : Për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr.9643, dt.20.11.2006 “Për prokurimin publik” me ndryshime, VKM nr.1, dt.10.01.2007, i shfuqizuar, Kreu II “Rregullat e përgjithshme të prokurimit, pika 2 “Llogaritja e vlerës së kontratës” dhe Kreu III “Dokumentat e tenderit, pika 3 “Informacione të veçanta”, gërma a “Kontratat për punë” dhe VKM nr.568, dt.27.06.2013 “Për miratimin e m,anualeve teknike të cmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” i shfuqizuar, konkretisht :</p>		Fq. 11-32 Pika 5.2 Raporti Përfundimtar i Auditimit	Në varësi të rezultateve të grupit të punës të ngritur për zbatimin e rekomandimit 1.1 të grupit B.2 të rekomandimeve, në përputhje me ligjin “Për nëpunësin civil”, do të vlerësohet situata për të disponuar në lidhje me masën disiplinore për nëpunësin z. Bujar Meta.		Anxhela Dishnica

	<p>a. Për përlogaritje më tepër të vlerës limit të kontratës në shumën <b>3.499.806 lekë pa TVSh.</b></p> <p>b. Për 18 raste “zëra punimesh” (pasqyra aneksi nr.2) nuk ka gjurmë, mbi mënyrën e përlogaritjes së cmimeve të preventivuara.</p>					
--	--	--	--	--	--	--

**MIRATOHET**

**KRYETARI**

**SOTIRAQ FILO**